URDHËR
Nr.50, datë 11.3.2011

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Brendshme më proceset gjyqësore, të lëshohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse, në emër të personit që do të përfaqësojë Ministrinë.

2. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Brendshme në proceset gjyqësore, sipas pikës 1 të këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të caktuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga ligji nr.8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.

3. Kompetencat e tjera procedurale, të parashikuara për titullarin e institucionit nga "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i delegohen Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse.

4. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në procesit gjyqësor të jetë sipas lidhjes nr.1 të këtij urdhri.

5. Për autorizimet e lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm deri në miratimin e këtij urdhri të ri, të cilat janë përdorur ose përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrit nr.642, datë 25.9.2009 "Për delegim kompetence", do të shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri të ri.

6. Për autorizimet e lëshuara sipas pikës 1 të këtij urdhri të ri, do të gjejë zbatim ky i fundit.

7. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Lulzim Basha